

d. nr. 8828

W-1797.doc/mfs
Departamenti Juridik
DRAFT Konfidencial
(subjekti do ndryshoje)
Jfunahashi
25 Prill, 2001

DRAFTI I PUNES FILLESTARE

846

13.11.01

KREDIA NUMER 3522 AL

MARREVESHJE E KREDISE SE ZHVILLIMIT

(Projekti i Sherbimeve Bujqesore)

ndermjet

SHQIPERISE

dhe

SHOQATES PER ZHVILLIM NDERKOMBETAR (IDA)

Data 3 Korri



NUMRI I KREDISE 3522 ALB

MARREVESHJA E KREDISE SE ZHVILLIMIT

MARREVESHJA. e dates 3 Korrik, 2001. midis SHQIPERISE (Huamarresi)
dhe SHOQATES PER ZHVILLIM NDERKOMBETAR (Shoqata).

MEQENESE: (A) Huamarresi, i bindur persa i perket fazes pergatitore dhe prioritetit
te Projektit te pershkruar ne Kapitullin 2 te kesaj Marreveshjeje, ka kerkuar
financimin e Projektit nga Shoqata:

MEQENESE Shoqata ka rene dakord ne parim. ndermjet te tjerash, per sa me siper. te
shtyje afatin e Kredise se Huamarresit sipas kushteve te percaktuara ne kete
Marreveshje:

QE KETEJE TUTJE te dyja palet bienen dakord si ne poshte:



NENI 1

Kushtet e Pergjithshme; Perkufizime

Seksioni 1.01 "Kushtet e Pergjithshme te Zbatueshme per Marreveshjet e Kredive te Zhvillimit" te Shoqates, i dates 1 Janar, 1985 (plotesuar ne 6 Tetor, 1999) me modifikimet e percaktuara me poshte (Kushtet e Pergjithshme) jane pjese perberese e kesaj Marreveshjeje:

(a) Nje paragraf i ri (12) i eshte shtuar Seksionit 2.01 i shenuar me poshte, dhe paragrafet ekzistuese (12) deri ne (14) te ketij Seksioni jane shenuar perkatesisht si paragrafet (13) deri ne (15):

"12. "Vend Pjesemarres" nenkupton cdo vend per te cilin Shoqata vendos te plotesoje kerkesat e percaktuara ne Seksionin 11 te Rezolutes No. 194 te Bordit te Guvernatoreve te Shoqates, i adoptuar me 8 Prill, 1999 dhe "Vendet Pjesemarrese" nenkupton te tilla vende bashkarisht; dhe

(b) Fjala e dyte e Seksionit 5.01 eshte modifikuar si me poshte:

"Pervet rasteve kur Shoqata dhe Huamarresi bien dakord, nuk do te behet asnje terheqje fondesh: (a) per shpenzime ne territoret e cdo vendi qe nuk eshte vend pjesemarres ose per mallra te prokuruar ne, ose sherbime te ardhura nga territoret e tilla; ose (b) per qellime pagese ndaj personave apo njesive, ose per importim mallrash, nese nje pagese apo importim i tille, sipas njohurive te Shoqates, ndalohet nga vendimi i Keshillit te Sigurise se Kombeve te Bashkuara percaktuar ne Kapitullin VII te Kartes se Kombeve te Bashkuara".

Seksioni 1.02. Nese nuk kerkohet ndryshe, disa terma te permendura ne Kushtet e Pergjithshme kane kuptimet perkatese te percaktuara aty dhe termat e meposhtme te shtuara kane kuptimet e meposhtme:

- (a) "CGC" nenkupton Komisionin e Granteve Konkurrese, te krijuar ne 20 prill, 2001 nepermjet Vendimit te PSC (ky percaktohet me poshte):
- (b) "Shpenzimet e Pranueshme" nenkupton shpenzimet per mallrat dhe sherbimet qe i referohen Seksionit 2.02 (a) te kesaj Marreveshje
- (c) "Plani i Menaxhimit te Ambientit" nenkupton planin, te pranueshem per Shoqaten, pergatitur dhe adoptuar nga Huamarresi ne perputhje me legjislacionin e Huamarresit, pershkruhet masat per mbrojtjen e ambientit, monitorimi dhe masat institucionale te Projektit.
- (d) "Grant" nenkupton nje grant te aprovuar nga CGC per qellimet e Pjeses D.2 te Projektit:
- (e) "Marresi i Grantit" nenkupton marresin e grantit, qe i ploteson kriteret e paragrafit 1 te Kapitullit 5 te kesaj Marreveshje
- (f) "Manuali i Veprimit" nenkupton manualin, qe eshte i pranueshem nga Shoqata, te vendosura per kriteret te pranueshme per NenProjektet dhe termat dhe kushtet e Grantit sipas Pjeses D.2 te Projektit.



- (g) "PMU" nenkupton Njesine e Manaxhimit te Projektit, e krijuar me Dekretin nr. 616 dt. 21 Dhjetor. 1999 ne MBU te Huamarresit, dhe ne perputhje me vendimet e paragrafit 2 te Kapitullit 4 te kesaj Marreveshje;
- (h) "Raporti i Manaxhimit te Projektit" nenkupton çdo raport te pergatitur ne perputhje me Seksionin 4.02 te kesaj Marreveshje.
- (i) "Paradhenie per Pregatitjen e Projektit" nenkupton qe paradhenia per pergatitjen e projektit dhene nga Shoqata Huamarresit sipas leter marreveshjes nenshkruar ne emer te Shoqates ne 22 Shtator 1999 dhe ne emer te Huamarresit ne 5 Janar 2000:
- (j) "PSC" nenkupton Komitetin Drejtues te Projektit, i cili perbehet nga Ministrat ose perfaqsesit e tyre nga Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomise dhe Bashkepunimit Ekonomik, Ministria e Pushtetit Lokal, si dhe nga Shefi i Regjistrimit te Huamarresit, i cili eshte pergjegjes per rishikimin dhe aprovimin e programit vjetor te punes dhe buxhetit te PMU, vendos prioritetet, duke zgjidhur konfliktet dhe lehtesuar zbatimin e programit te punes se aprovuar.
- (k) "Llogaria e Vecante" nenkupton llogarine qe i referohet Pjeses B ne Kapitullin 1 te kesaj Marreveshje

(l) "NenProjekte(t)" nekupton nenProjekte(t) e aprovuara nga CGC te financuara nga Granti per qellimet e Pjeses D.2 te Projektit; dhe

(m) "Zyra e Regjistrimit te Tiranes" nenkupton zyren e regjistrimit te pasurive te paluajteshme qe i sherben rajonit te Tiranes te Huamaresit.



NENI II

Kredia

Seksioni 2.01. Shoqata bie dakord t'i jape hua Huamarresit, sipas termave dhe kushteve te percaktuara ose te referuara ne Marreveshjen e Kredise se Zhvillimit, nje shume ne valuta te ndryshme te barasvlefshme me shtatemilioneteteqindepesedhjetemije. Te Drejta te Vecanta te Terheqjes (SDR7.850.000).

Seksioni 2.02. (a) Shuma e Kredise mund te terhiqet nga Llogaria e Kredise ne perputhje me vendimet e Kapitullit 1 te kesaj Marreveshjeje per shpenzimet e bera (ose, nese Shoqata do te bjere dakord) ne lidhje me koston e arsyeshme te mallrave dhe sherbimeve te kerkuara per Projektin dhe qe do te financohen nga Kredia.

(b) Huamarresi mund, per qellimet e Projektit, te hape dhe te mbaje ne U.S.DS nje llogari te vecante bankare sipas termave dhe kushteve te pranueshme per Shoqaten perfishre mbrojtjen nga kalimet e gabuara dhe vjedhjet, abuzimet. Depozitimet dhe pagesat nga Llogaria Speciale do te behen ne perputhje me kushtet e percaktuara ne Kapitullin 1 te kesaj Marreveshjeje.

(c) Menjehere mbas Dates te hyrjes ne fuqi, Shoqata do te terheqe, ne emer te Huamarresit, nga Llogaria e Kredise dhe do te paguaje vetvetes shumen e kerkuar per te ripaguar shumen kryesore te Paradhenies per Pergatitjen e Projektit e terhequr dhe e pashpenzuar dhe do te paguaje te gjitha borxhet papaguara deri ne kete kohe. Bilanci i shumes e autorizuar te paterhequr te Paradhenies per Pergatitjen e Projektit do te anulohet.

Seksioni 2.03. Data e Perfundimit do te jete 31 Dhjetor 2007, ose nje date e mevonshme qe percaktohet nga Shoqata. Shoqata do te njoftoje menjehere Huamarresin per kete date te mevonshme.

Seksioni 2.04. (a) Huamarresi do t'i paguaje Shoqates nje tarife mbi shumen e Kredise qe nuk mund te terhiqet here pas here ne baze te nje %, sic percaktohet nga Shoqata, me 30 Qershor te çdo viti, por qe nuk duhet te kaloje gjysmen e 1 perqindeshit per vit (1/2 e 1%).

(b) Tarifa do te rritet: (i) 60 dite pas dates se kesaj Marreveshjeje (data e rritjes) deri ne datat perkatese ne te cilat shumat do te terhiqen nga Huamarresi nga Llogaria e Kredise ose do te anulohen; dhe (ii) ne nje perqindje te vendosur ne 30 Qershor qe menjehere paraprin daten e rritjes ose te tjera ne perqindje qe mund te percaktohen here pas here ne vijim te paragrafit (a) me lart. Perqindja e vendosur ne 30 Qershor ne cdo vit do te aplikohet nga data e pageses tjeter ne ate vit te percaktuar ne Seksionin 2.06 te kesaj Marreveshje.

(c) Tarifa do te paguhet: (i) ne vendet qe Shoqata do te kete kerkesa te aresyeshme; (ii) pa asnje lloj kufizimi te imponuar nga, ose ne territorin e Huamarresit; dhe (iii) ne valuten e percaktuar ne kete Marreveshje per qellimet e Seksionit 4.02 te Kushteve te Pergjithshme ose ne nje valute ose valuta te tjera te pranueshme qe here pas here mund te percaktohen ose perzgjidhen ne vijim te vendimeve te ketij Seksioni.

Seksioni 2.05. Huamarresi do t'i paguaje Shoqates nje tarife sherbimi sipas koeficientit tre te katertat e nje perqindeshit ($3/4$ e 1%) ne vit mbi shumen e Kredise se terhequr dhe te pashpenzuar here pas here.

Seksioni 2.06. Tarifat dhe tarifat e sherbimeve do te paguhen cdo gjashte muaj ne 15 Janar dhe 15 Korrik ne cdo vit.

Seksioni 2.07. (a) Lenda e paragrafeve (b), (c) dhe (d) me poshte. Huamarresi do te ripaguaje shumen e Kredise me keste gjashte - mujore te pagueshme ne cdo 15 Janar dhe 15 Korrik duke filluar ne vitin 2011. dhe duke mbaruar ne 15 Janar 2041. Cdo kest. duke perfshire dhe kestin e paguar ne 15 Janar 2021 do te jete nje perqind (1%) e kesaj shume. dhe cdo kest pas kesaj do te jete dy perqind (2%) e kesaj shume.

(b) Kur: (i) prodhimi i pergjithshem kombetar (GNP) i Huamarresit. sic percaktohet nga Shoqata. do te kete tejkaluar per tre (3) vite te njeperqindeshem nivelin e krijuar cdo vit nga Shoqata per t'i hapur rrugen burimeve te Shoqatave dhe (ii) Banka do te konsideroje vlefshmerine e kredise se Huamarresit per huadhenie nga Banka. Shoqata mund te modifikoje. menjehere pas rishikimit dhe miratimit te Drejtuesve Ekzekutive te Shoqates dhe pas marrjes ne konsiderate nga ana e tyre e zhvillimit te ekonomise se Huamarresit. ripagimin e kesteve nen paragrafin (a) me lart duke:

(A) i kerkuar Huamarresit te ripaguaje dyfishin e shumes se çdo kesti akoma te papaguar deri sa te ripaguhet shuma e Kredise: dhe

(B) i kerkuar Huamarresit te filloje ripagimin e shumes se Kredise persa i perket dates se pageses se pare gjashte-mujore se ciles i referohet paragrafi

(a) me lart pas gjashte (6) muajve ose me teper pas dates ne te cilen Shoqata.

njofton Huamarresin se jane realizuar situatat e permendura ne paragrafin

(b). por. megjithate, do te lihet nje periudhe minimumi prej pese (5) vjetesh per kete ripagim

(c) Nese kerkohet nga Huamarresi. Shoqata mund te rishqyrtoje modifikimet e referuara ne paragrafin (b) me lart, per te perfshire, te gjitha rritjet ne shumet e ketyre kesteve, pagesa e interesit ne nje interes vjetor per te cilin ka rene dakord Shoqata mbi shumet e Kredise se terhequr dhe te pashpenzuar here pas here, ne menyre qe, sipas gjykimit te Shoqates, rishqyrtimi nuk do te ndryshoje elementin e perfutur te Grantit nga modifikimi i ripageses se mesiperme.



(d) Nese, pas modifikimit te termave ne vijim te paragrafit (b) me lart, Shoqata ve re se situata ekonomike e Huamarresit ka rene ne menyre te ndjeshme, Shoqata, nese kerkohet nga Huamarresi, mund te modifikojë me tej termat e ripagimit per te qene ne konformitet me grafikun e kesteve te percaktuara ne paragrafin (a) me lart.

Seksioni 2.08. Valuta e Shteteve te Bashkuara te Amerikes specifikohet per qellime te
Seksionit 4.02 te Kushteve te Pergjithshme.



NENI III

Ekzekutimi i Projektit

Seksioni 3.01. (a) Huamarresi deklaron perkushtimin ndaj objektivave te Projektit te percaktuara ne Kapitullin 2 te kesaj Marreveshje, se do te zbatoje Projektin nepermjet PMU-se me eficience te plote dhe ne konformitet me praktikat e duhura administrative, financiare do te siguroje, sapo te jete nevoja, fondet, pajisjet, sherbimet dhe te tjera burime te kerkuara per Projektin: dhe

(b) Pa kufizuar vendimet e paragrafit (a) te ketij Seksioni dhe ne rast se Huamarresi dhe Shoqata bien dakord ndryshe, Huamarresi do te (i) zbatoje Projektin ne perputhje me Programin e Zbatimit te Percaktuar ne Kapitullin 4 te kesaj Marreveshje: dhe (ii) do te zbatoje Pjesen D.2 te Projektit ne perputhje me Manualin e Veprimit dhe termat dhe kushtet te percaktuara ne Kapitullin 5 te kesaj Marreveshje.

Seksioni 3.02. Ne rast se Shoqata do te bjere dakord, prokurimi i mallrave, punimeve dhe sherbimeve te konsulenteve qe kerkohen per Projektin dhe qe do te financohen nga fondet e Kredise do te behet sipas vendimeve te Kapitullit 3 te kesaj Marreveshjeje.

Seksioni 3.03. Per qellime te Seksionit 9.06 te Kushteve te Pergjithshme dhe pa kufizime, Huamarresi do te:

(a) do te pergatise ne baze te udhezimeve te pranueshme per Shoqaten, dhe do t'i dergoje Shoqates jo me vone se gjashte (6) muaj pas Dates se Perfundimit ose ne nje date te mevonshme sic mund te bihet dakord per kete qellim midis Huamarresit dhe Shoqates. nje plan per ecurine e Projektit ne te ardhmen; dhe

(b) do t'i siguroje Shoqates mundesi te arsyeshme per te shkëmbyer pikepamje me Huamarresin mbi planin e mesiperm.



NENI IV

Pakti Financiar

Seksioni 4.01 (a) Huamarresi do te mirembaje nje sistem manaxhimi financiar, duke perfshire arshivimet dhe llogarite, dhe te pergatise gjendjet financiare ne perputhje me standartet e pranueshme per Shoqaten, te pershtatshme per te reflektuar veprimet, burimet dhe shpenzimet qe lidhen me Projektin.

(b) Huamarresi do te:

- (i) per te pasur rregjistrimet, llogarite dhe pasqyrat financiare te referuara ne paragrafin (a) te ketij Seksioni duke perfshire rregjistrimet dhe llogarite per Llogarine e Vecante per cdo vit fiskal te audituar, ne perputhje me standartet audituese te pranueshme per Shoqaten, qe vazhdojne te zbatohen, nga auditues te pavarur te pranueshem per Shoqaten:
- (ii) per t'i dorezuar Shoqates sa me shpejt te jete e mundur, por ne cdo rast jo me vone se gjashte (6) muaj pas cdo fund viti (A)kopjen e pasqyres financiare, qe i referohet paragrafit (a) te ketij viti te audituar, dhe (B) nje opinion per pasqyrat financiare, rregjistrimet dhe llogarite, raportin e auditit, qellimin dhe disa hollesira te cilat jane kerkuar nga Shoqata; dhe

(iii) per te informuar Shoqaten ne lidhje me regjistrimet, llogarite dhe auditimin sic do te kerkoje Shoqata here pas here.

(c) Per te gjitha shpenzimet ne lidhje me te cilat jane bere terheqje fondesh nga Llogaria e Kredise ne baze te pasqyres se shpenzimeve, Huamarresi:

(i) do te mirembaje, ne perputhje me paragrafin (a) te ketij Seksioni, regjistrimet dhe llogarite qe reflektojne keto shpenzime:

(ii) do te ruaje, deri te pakten nje vit pasi Shoqata te kete marre raportin e auditimit per vitin fiskal ne te cilin u be terheqja e fundit e fondeve nga Llogaria e Kredise, te gjitha regjistrimet (kontratat, urdherat, faturat, pagesat dhe dokumenta te tjere) qe pasqyrojne keto shpenzime:

(iii) do te ndihmoje perfaqesuesit e Shoqates per te analizuar keto regjistrime: dhe

(iv) do te siguroje se te regjistrimet dhe llogarite jane perfshire ne auditimin vjetor duke ju referuar paragrafit (b) te ketij Seksioni dhe se raporti i auditimit

permban nje opinion te vecante te audituesve persa i perket faktit nese pasqyra e shpenzimeve te paraqitura gjate vitit fiskal bashke me procedurat dhe kontrollat e brendshme te perfshira ne pergatitjen e tyre, mund te besohen per te justifikuar terheqjen e fondeve qe lidhen me to.

Seksioni 4.02. (a) pa kufizimet e vendimeve ne Seksioni. 4.01 te kesaj Marreveshje. Huamarresi do te kryejë nje plan veprimi ne kohe te miratuar nga Shoqata per fuqizimin e sistemit manaxhimit financiar qe i referohet paragrafit (a) te Seksionit 4.01 per Huamarresin. jo me vone se 30 Qershor, 2002, ose jo me vone se data e miratimit nga Shoqata, te pergatise Raportet tremujore te Manaxhimit te Projektit, te pranueshem nga Shoqata, per:

- i) (A) te percaktoje burimet aktuale dhe aplikimet e fondeve per projektin, kumulative dhe per periudhen per te cilen raportohet, dhe burimet e projektit dhe aplikimet e fondeve per periudhen 6 mujore mbas periudhes te raportit te meparshem, dhe (B) te tregojë ndarjen e fondeve te financuara gjate Kredise dhe periudhes per te cilen raportohet dhe shpenzimet e propozuara per tu financuar gjate Kredise dhe gjate gjashtemujorit qe ndjeko periudhen qe raportohet:

- ii) (A) pershkruan progresin fizik te Zbatimit te Projektit, si per periudhen e meparshme dhe per periudhen qe

raportohet. dhe (B) shpjegon ndryshimet
midis objektivave te parashikuara me ato aktuale; dhe

- iii) vendosja e statusit te prokurimit te Projektit dhe shpenzimet ne kontratat e financuara nga Kredia, si dhe ne fund te periudhes qe raportohet.

(b) Per kompletimin e planit te veprimit qe i referohet paragrafit (a) ketij Seksioni. Huamarresi do te pergatise, ne perputhje me udhezimet e aprovuara nga Shoqata, dhe tia paraqese Shoqates jo me vone se 45 dite mbas mbarimit te Raportit tremujor te Menaxhimit te Projektit per kete periudhe.



NENI V

Demshperblimet e Shoqates

Seksioni 5.01. Sipas Seksionit 6.02 (1) te Kushteve te Pergjithshme, çeshtjet shtese te meposhteme specifikohen:

(a) Manuali i Veprimit duhet te permisohe, pezullohet, shfuqizohet, anullohet ose shtyhet, ose vendimet ligjore duhet te miratohen, qe ndikon ne opinionin e Shoqates per te realizuar Projektin.

(b) Ligji Nr. 8732 i dates 24 Janar 2001 ka permisuar, pezulluar, shfuqizuar, anuluar ose shtyre te cilat ndikojne ne opinionin e Shoqates per realizimin e Projektit.

Seksioni 5.02. Sipas Seksionit 7.01 (h) te Kushteve te Pergjithshme specifikohet çeshtje shtese te mevonshme, kryesisht, nese ngjarjet e specifikuara Seksioni 6.01 (a) dhe (b) te kesaj Marreveshje do te ndodhin.

NENI VI

Perfundimi

Seksioni 6.01. Nentëdhjetë dite (90) dite pas dates së kësaj Marrëveshje të specifikuar për qëllimet të Seksionit 12.04 të Kushteve të Përgjithshme



NENI VII

Perfaqsesi i Huamarresit: Adresat

Seksioni 7.01 Ministria e Financave e Huamarresit eshte percaktuar si perfaqsesi e Huamarresit per qellimet e Seksionit 11.03 te Kushteve te Pergjithshme.

Seksioni 7.02. Adresat e meposhtme jane specifikuar per qellimet e Seksionit 11.01 te Kushteve te Pergjithshme:

Per Huamarresin:

Ministria e Financave
Bulevardi "Deshmoret e Kombit"
Tirana
Shqiperia

Fax:

355 42 28494

Per Shoqaten

International Development Association
1818 H Street, N.W
Washington, D.C. 20433
United States of America
Adresa elektronike: INDEVAS
Washington, D.C.

Teleks:

248423(MCI) ose
64145(MCI)



DESHMITARET e te dyja paleve, duke vepruar si perfaqesues te autorizuar, nenshkruan kete Marreveshje ne emer te tyre ne Shtetin e Kolumbise. Shtetet e Bashkuara te Amerikes, ne ditën dhe vitin e shenuar me siper.

SHQIPERIA

Nga *FATOS TARIFA*
AMBASADOR

Perfaqesues i Autorizuar

SHOQATA E ZHVILLIMIT NDERKOMBETAR

Nga *CHRISTIAN POORTMAN*

Zevendes President i Rajonit te
Evropes dhe Azise Qendrore



KAPITULLI 1

Terheqja e Fondeve te Kredise

A. Te pergjithshme

1. Tabela e meposhtme percakton Kategorite e artikujve qe financohen nga fondet e Kredise. alokimin e shumave te Kredise per cdo Kategori dhe perqindjen e shpenzimeve per artikujt qe financohen ne cdo Kategori:

<u>Kategoria</u>	Shuma e Kredise	
	se Alokuar (shprehur ne SDR) ¹⁰	% e shpenzimeve qe do te financohen
(1) Grandet ne Pjesen D.2	1.180.000	75%
(2) Punime Civile		80%
a) Pjesa B e Projektit	450 000	
b) Pjeset e tjera pervec B	2 000 000	
(3) Mallrat	1 100 000	100% Shpenzime te huaja
		100% Shpenzime te vendit (koste e ish-fabrikes)
		85% e Shpenzimeve te vendit per mallra te tjera te prokuruar ne vend

<u>Kategoria</u>	Shuma e Kredise se Alokuar (shprehur ne SDR)	% e shpenzimeve qe do te financohen
(4) Sherbimet e Konsulentëve, dhe trainimi	1 360 000	100 %
(5) Kosto operative shtese	690 000	70%
(6) Rifinancimi i Paradhenies per Pregatitjen e Projektit	440 000	(Shuma e percaktuar ne Seksioni 2.02 (b) te kesaj Marreveshje)
(7) Te paalokuara	630 000	
TOTALI	<u>7.850.000</u>	

2. Per qellimet e ketij Kapitulli:

(a) termi "shpenzime te huaja" nenkupton shpenzimet ne valuten e nje vendi tjeter pervec atij te Huamarresit per mallra ose sherbime te furnizuara nga territori i nje vendi tjeter pervec atij te Huamarresit; dhe

(b) termi "shpenzime lokale" nenkupton shpenzimet ne valuten e Huamarresit per mallra ose sherbime te furnizuara nga territori i Huamarresit: te siguruar, sidoqofte, nese valuta e Huamarresit eshte e nje vendi tjeter nga territori nga i cili kane ardhur mallrat ose

shërbimet, shpenzimet në këtë valutë për mallrat dhe shërbimet do të quhen "shpenzime të huaja"

(c) termi "kosto shtesë operative" nënkupton shpenzimet shtesë të lidhura me zbatimin e Projektit ku përfshihen kosto e zyrës dhe mirëmbajtjen e automjeteve, të nevojshme, pajisje të vogla zyre, pagat e stafit përjashtuar punonjësit civilë, transporti, kosto e riparimit të automjeteve dhe pajisjeve, auditimi dhe aktivitete të tjera të lidhura me menaxhimin, monitorimin dhe zbatimin e Projektit.

mesipër, asnjë dëshmi nuk do të behet në lidhje me:

(a) pagesat për shpenzime të bera para datës së kësaj Marrëveshjeje; dhe

(b) pagesat për shpenzime në kategorinë 2 të tabelës së regjistrimit për shërbimet të kryera në vijë të vijës së njerezve duke hartuar një plan veprimi të pranueshëm nga Shoqata në 31 Dhjetor 2001.

4. Shoqata mund të kërkojë tërheqje nga Llogaria e Kësaj në bazë të pasqyrave të shpenzimeve për shpenzime: i) Punime me kontratë = ose më të vogla se 250 000 \$; ii) mallrat me kontratë = ose më të ulëta se 75 000 \$; iii) Shërbimet me kontratë me firmat konsultuese = ose më të vogla se 50 000 \$; iv) shërbimet për kontratat me konsulentët individualë me vlerë = ose më të vogla se 25.000\$; v) kosto operative shtesë dhe trainimet; vi) Grandet sipas termave dhe kushteve të specifikuar nga Shoqata dhe për të cilën lajmëron Huamarrësin.

B. Llogaria Speciale

1. Huamarresi do të hape dhe do të mbaje në Dollare një depozitë të vecantë bankare, në termat dhe kushtet të aprovuara nga Shoqata, duke marrë masa mbrojtëse për kalim pagese të gabuara, për ndonjë grabitje.

2. Pasi Shoqata të ketë marrë evidenca të pranueshme të Llogaria të Vecantë është hapur, tërheqjet e fondeve nga Llogaria e Kredite dhe tërheqjet e mëposhtme për të depozituar në Llogarinë e Vecantë do të behen si më poshtë:

(a) kur Shoqata do të marrë (i) raportin e parë të Manaxhimit të Projektit që i referohet Seksionit 4.02 (b) të kësaj Marrëveshjeje dhe (ii) një kërkesë nga Huamarresi për tërheqje në bazë të Raporteve të Manaxhimit të Projektit, tërheqjet do të behen në përputhje me parashikimet e Aneksit A të Kapitullit 1: dhe

(b) sapo të marrë nga Shoqata, Raportin e Manaxhimit të Projektit sipas Seksionit 4.02 (b) të kësaj Marrëveshjeje, të shoqëruar nga një kërkesë e Huamarresit për tërheqje në bazë të Raporteve të Manaxhimit të Projektit, të gjithë tërheqjet e mëposhtme do të behen në përputhje me parashikimet e Aneksit B të këtij Kapitulli.



3. Pagesat nga Llogaria e Vecantë do të behen ekskluzivisht për Shpenzime të Pranueshme. Për çdo pagesë të bërë nga Huamarresi nga Llogaria Speciale, Huamarresi duhet, në kohën që do të kërkojë Shoqata, do të dërgojë dokumenta dhe evidenca të tjera ku tregohen pagesat e bera ekskluzivisht për Shpenzimet e Pranueshme.

4. Megjithate parashikimet e Pjeses B.2 te ketij Kapitulli, Shoqates nuk do ti kerkohet te beje depozita te metejshme ne Llogarine Speciale:

(a) nese Shoqata vendos qe ndonje Raport i Manaxhimit te Projektit nuk i ploteson informacionet e kerkuara sipas Seksionit 4.02 te kesaj Marreveshje;

(b) nese Shoqata vendos ne cdo kohe qe te gjitha terheqjet e metejshme duhet te behen nga Huamarresi direkt nga llogaria e kredise; ose

(c) nese huamarresi nuk do te arrije t'i paraqese Shoqates brenda periudhes se kohes se specifikuar ne Seksioni 4.01 (b) (ii) te kesaj Marreveshje, ndonje raport audit i kerkuar per t'u dorezuar Shoqates sipas Seksionit (A) regjistrimet dhe llogarite per Llogarine Speciale ose (B) regjistrimet dhe llogarite e shpenzimeveper te cilat jane bere terheqjet ne baze te Raporteve te Manaxhimit te Projektit.

5. Shoqates nuk do ti kerkohet te beje depozita te metejshme ne Llogarine Speciale ne perputhje me parashikimet e Pjese B.2 te ketij Kapitulli, nese Shoqata duhet te njoftoje Huamarresin per qellim te pezulloje te gjitha ose nje pjese te drejtes se Huamarresit per te terhequr nga Llogaria e Kreditit sipas Seksionit 6.02 te Kushteve te Pergjithshme. Me marrjen e ketij njoftimi, Shoqata do te vendose, ne punen e saj, kur depozitat e metejshme ne Llogarine Speciale mund te behen dhe cfare procedurash duhet te ndiqen per te bere keto depozita, dhe duhet te njoftoje Huamarresin per vendimin.

6. (a) Nese Shoqata vendos qe ndonje nga pagesat nga Llogaria Speciale jane bere per shpenzime te cilat nuk jane shpenzime te pranueshme. ose nuk justifikohen me evidencat e derguara Shoqates. Huamarresi do te njoftoje Shoqaten menjehere. per te siguruar evidencat shtese si dhe Shoqata mund te kerkoje. ose te depozitoje ne Llogarine Speciale(ose. nese Shoqata do te kerkoje. refinancimin e Shoqates) nje shume te barabarte me shumen e kesaj pagese. Perndryshe Shoqata do te bjere dakort, asnje depozite e metejshme nga Shoqata ne Llogarine Speciale nuk do te behet derisa Huamarresi do te siguroje evidenca ose do te krijojte depozita. sipas rastit

(b) Nese Shoqata vendos qe ndonje shume e pashpenzuar ne Llogarine Speciale nuk do te kerkohet per te mbuluar pagesat per Shpenzimet e Pranueshme gjate periudhes gjashte mujore mbas vendimit. Huamarresi. menjehere sapo te marre njoftimin nga Shoqata. do tia refinancoje Shoqates kete shume te pashpenzuar.

(c) Huamarresi mund. me njoftimin e Shoqates. te refinancoje te gjithe ose nje pjese te fondeve te depozituara ne Llogarine Speciale



(d) Rifinancimi i fondeve te Shoqates bazuar ne nen- paragrafet (a), (b) ose (c)

te paragrafit 6 do te kreditohet te Llogaria Kredise per terheqjet e
mevonshme ose per anulimin ne perputhje me vendimet perkatëse te
Marreveshjes se Zhvillimit te Kredise.



Aneksi A

Per

Kapitullin 1

Si do te veprohet me Llogarine Speciale kur terheqjet nuk jane bere ne baze te

Raporteve te Manaxhimit Financiar

1. Per qellimet e ketij Aneksi:

(a) termi "Alokim i Autorizuar" nenkupton nje shume baraz me 500.000\$ USD qe do te terhiqen nga Llogaria e Kredise dhe do te depozitohen ne Llogarine e Vecante ne sipas paragrafit 2 te ketij Aneksi, te sigurohet sidoqofte, se Shoqata duhet te aprovoje ate. Alokim i Autorizuar duhet te jete i kufizuar per nje shume te barabarte me 250.000\$ derisa shuma totale e terheqjes nga Llogaria Kredise, plus vleren totale te fondeve speciale te pashpenzuar te hyra ne Shoqate sipas Seksionit 5.02 te Kushteve te Përmirësimit do te jete e barabarte ose te kaloje shumen e 2.000.000 SDR.

2. Terheqjet e fondeve te Alokimit te Autorizuar dhe terheqjet e mepasshme per tu depozituar ne Llogarine e Vecante do te behen si me poshte:

(a) Per terheqjet e Alokimit te Autorizuar, Huamarresi do t'i paraqese Shoqates nje kerkese ose kerkesat per nje depozitim ne Llogarine Speciale, shuma totale nuk duhet te kalojne shumen e Alokimit te Autorizuar.


Ne baze te kesaj kerkese, Shoqata, ne emer te Huamarresit, do te terheqe nga Llogaria e Kredise dhe do te depozitoje ne Llogarine e Vecante shumen qe ka kerkuar Huamarresi.

(b) Per hyrjen e parave ne Llogarine e Vecante, Huamarresi do te dorezoje Shoqates kerkesen per depozitime ne Llogarine e Vecante ne intervalet qe do te percaktoje Shoqata. Para ose ne kohen e kesaj kerkese, Huamarresi do ti dorezoje Shoqates dokumentat dhe evidenca te tjera qe kerkohen ne sipas paragrafit B.3 te Kapitullit 1 te kesaj Marreveshje per pagesen ose pagesat ne lidhje me te cilat kerkohet hyrja e parave. Ne baze te seciles kerkese, Shoqata, ne emer te Huamarresit, do te terheqe nga Llogaria e Kredise dhe do te depozitoje ne Llogarine e Vecante shumen e kerkuar nga Huamarresi sic eshte paraqitur ne dokumentat ne fjale dhe evidencat e tjera se pagesat jane bere nga Llogaria e Vecante per Shpenzime te Pranueshme.

Cdo depozite ne Llogarine Speciale do te terhiqet nga Shoqata nga Llogaria Kredise sipas Kategorive te pranueshme. Cdo depozite do te terhiqet nga Shoqata nga Llogaria e Kredise nen Kategorite e Pranueshme perkatese.

3. Shoqates nuk do ti kerkohet te beje depozitime te metejshme ne Llogarine Speciale, shuma totale e paterhequr e Kredise, duke zbritur shumen e ndonje detyrimi te vecante te papaguar te futur ketu nga Shoqata ne perputhje me Seksionin 5.02 te Kushteve te Pergjithshme ne lidhje me Projektin, do te jete e barabarte me dyfishin e shumes se Alokimit te Autorizuar. Pas kesaj, terheqja nga Llogaria e Kredise e shumes se Kredise e mbetur e paterhequr, e alokuar per Kategorite e pershtatshme do te ndjehet procedurat per te cilat Shoqata do te njoftoje Huamarresin. Terheqjet e metejshme do te behen vetem pasi dhe deri ne ate mase qe do te kerkoje Shoqata qe te gjitha keto shuma te mbetura te depozituara ne

Llogarinet e Vecante deri ne daten e ketij njoftimi do te perdoren per pagesa te Shpenzimeve te Pranueshme.



Aneksi B

Per

Kapitullin 1

Veprimet e Llogarise Speciale

Kur Terheqjet jane bere

Ne baze te Raporteve te Manaxhimit te Projektit

1. Përvec Shoqates duhet të specifikohet edhe me një lajmerim edhe Huamarresi, të gjithë terheqjet nga Llogaria e Kredise do të depozitohen nga Shoqata në Llogarinë Speciale në përputhje me vendimet e Kapitulli 1 të kësaj Marrëveshjeje. Cdo depozitë në Llogarinë Speciale do të terhiqet nga Shoqata nga llogaria e Kredise nën një ose disa kategori të Pranueshme të Llogarise Speciale.

2. Cdo aplikim për terheqje nga Llogaria e Kredise për depozite në Llogarinë Speciale do të shoqerohet nga Raporti i Manaxhimit të Projektit.

3. Me marrjen e cdo aplikimi për terheqje të një shume të kredise, Shoqata do të terheqë nga Llogaria e Kredise, në emër të Huamarresit dhe do të depozitojë në Llogarinë Speciale një shume të barabartë ose më pak se: (a) shuma e kerkuar; dhe (b) shumës së ciles Shoqata ka vendosur, bazuar në Raportin e Manaxhimit të Projektit që shoqeron aplikimin, që kerkohet të depozitohet për të financuar Shpenzimet e Pranueshme gjatë periudhës gjashtëmujore mbas datës të këtij raporti; do të sigurojë që shuma është depozituar, kur i shtohet shumës së treguar në Raportin e Manaxhimit të Projektit për të mbetur në Llogarinë Speciale, nuk duhet të kalojë shumën 500.000 \$

KAPITULLI 2

Pershkrimi i Projektit

Objektivi i Projektit eshte rritja e te ardhurave rurale ne teritorin e Huamarresit nepermjet: (i) permisimit te hyrjes se fermereve te vegjel me farera cilesore; (ii) ndihmoje Huamarresin per nje funksionim me te mire te tregut te tokes; (iii) permisimi i pjesmarrjes se fermereve te vegjel ne aktivitetet e tregut; dhe (iv) permisimi i hyrjes dhe adoptimit te teknologjise te fermeret e vegjel per diversifikim e prodhimeve potenciale.

Projekti konsiston ne pjeset e meposhtme, qe do i nenshtrohen modifikimeve per te cilat Huamarresi dhe Shoqata mund te bien dakord here pas here per te arritur objektivat:



Pjesa A: Zhvillimi i Tregut te Fares

1. Sigurimi i asistences teknike per mallrat dhe trainimi per te permisuar kuadrin regullator dhe institucional te fares per te harmonizuar me standartet nderkombetare, duke perfshire promovimin te regjistrimit vullnetar te farerave dhe liberalizimin e certifikimit te farerave.
2. Sigurimi i mallrave, i asistences teknike dhe trainimi per fuqizimin e institucioneve publike te lidhura me trainimin dhe kerkimin.

Pjesa B: Zhvillimi i Tregut te Tokes

1. Dispozitat per mallrat, punimet, koston operative shtese asistencen teknike dhe trainimet per zhvillimin e sistemimit te pasurive te paluajtshme, te cila kane per qellim te permisojne vlefshmerine, hyrjen dhe sigurine e transaksioneve te tregut te tokes.
2. Dispozitat e mallrave asistences teknike dhe trainimi per aktivitetet pilot te konsolidimit te tokes do te lehtesojne konsolidimin e tokes tejet te copezuar nepermjet mekanizmeve te tregut me qellim permisimin e efikasitetit te veprimeve te tregut te tokes dhe produktivitetit bujqesor.

Pjesa C: Rehabilitimi i tregut

Dispozitat per mallrat, asistencen teknike dhe trainimin me qellim te (i) te lehtesoje marketingun e produkteve primare bujqesore; (ii) permisimi i manaxhimit te tregjeve bujqesore rurale dhe urbane te selektuara; dhe (iii) fuqizimi i kapaciteteve institucionale me Ministrine e Bujqesise dhe Ushqimit dhe ne bashkite lokale te Huamarresit per te monitoruar dhe kontrolluar aktivitetet e tregut.

Pjesa D: Permisimi i marketingut dhe rendimentit rural bazuar ne – komunitet

1. Dispozitat e mallrave, asistences teknike dhe trainimi per: (i) shpejtimin e transferimit te teknologjise dhe permisimin e praktikave te biznesit te komunitetit rural; (ii) asistojne ne krijimin e shoqatave te fermereve dhe grupeve te tjera te komunitetit per te fituar nga mundesite ekonomike, si manaxhimi i projekteve te donatoreve; (iii)

asistojë Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit të Huamarrësit për të krijuar lidhjet midis fermerëve dhe agrobizneset.

2. Dispozitat e Grantit për përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Manualin e Veprimit dhe Kapitullit 5 të kësaj Marrëveshjeje në mbështetje të zbatimit të nënprojekteve për të adoptuar dhe përhapur teknologjitë e përshatshme të disenguara për rritjen e rendimentit rural, shtimin e vlerës, rritjen e pranueshmërisë në treg të produkteve bujqësore.

Pjesa E: Manaxhimi i Projektit

Dispozitat e asistencës teknike, kosto operative mjedhëse dhe shërbimet e auditimit të asistojë në zbatimin sa më efektiv të aktiviteteve të Projektit



Projekti pritet të përfundojë më 30 Qershor 2007.

KAPITULLI 3

Prokurimi dhe Sherbimet e Konsulences

Seksioni I. Prokurimi i Mallrave dhe PunimevePjesa A: Te pergjithshme

1. Mallrat dhe punimet do te prokurohen ne perputhje me: (a) vendimet e Seksionit I te "Udhezime per Prokurime nen Kredite IBRD dhe IDA" botuar nga Banka ne Janar 1995 dhe rishikuar ne Janar dhe Gusht 1996, Shtator 1997 dhe Janar 1999, dhe vendimet e Pjeseve te meposhme te Seksionit I.

3. Ne paragrafet 1.6 dhe 1.8 te Udhezimeve, referencat "vendet anetare te Bankes" dhe "vend anetar" do te mendohen si referenca (perkatesisht) te "Vendet Pjesemarrese" dhe "Vend Pjesemarres".

Pjesa B: Procesi i Konkurimit Nderkombetar

(1.) Sic eshte pereaktuar ne Pjesen C te ketij Seksioni, mallrat dhe punimet do te prokurohen sipas kontratave te lidhura ne perputhje me vendimet e Seksionit II te Udhezimeve dhe paragrafit 5 te Shtojces 1 bashkangjitur.

- (2.) Vendimet e meposhtme do te aplikohen per mallrat dhe punimet qe do te prokurohen per kontratta te lidhura ne pershtatje me vendimet e paragrafit 1 te Pjeses B.

(a) Grupimi i kontratave

Per te zgjeruar praktikisht, kontratat per mallrat duhet te grupohen ne paketa te medha me kosto te vleresuar \$75 000 ekuivalente ose me shume.

(b) Preferencat per mallrat te prodhuar ne vend dhe kontraktoret e vendit

Vendimet e paragrafeve 2.54 dhe 2.55 te Udhhezimeve dhe Aneksi 2 do te aplikohet per mallrat te prodhuara ne territorin e (Huamarresit).



(c) Njoftimi dhe lajmerimi

Njoftimi per parakualifikim ose tender per cdo kontrate 10.000.000\$ ose me shume duhet te behet ne pershtatje me procedurat qe aplikohen per kontrata te medha sipas paragrafit 2.8 te Udhhezimeve.

Pjesa C: Procedura te Tjera Prokurimi

1. Procesi i Konkurimit Kombetar

Punimet me kosto te vleresuar = ose me pak se \$500 000 per kontrate deri ne nje shume qe nuk e kalon \$2.078.000 mund te prokurohen nen kontratat e lidhura ne perputhje me vendimet e paragrafeve 3.3 dhe 3.4 te Udhezimeve.

3. Blerja Nderkombetare

Mallrat me kosto te vleresuar = ose me pak se \$ 75.000 per kontrate, deri ne nje shume qe nuk e kalon \$157.000, mund te prokurohen nen kontratat e lidhura ne baze te procedurave te blerjeve nderkombetare kombetare ne perputhje me vendimet e paragrafeve 3.5 dhe 3.6 te Udhezimeve.

3 Blerje Kombetare

Mallrat te vleresuara me kosto = ose me pak se \$ 30 000 deri ne nje shume te barabarte ose nuk e kalon \$ 99.000 mund te prokurohen per kontrata te lidhura ne baze te procedurave te blerjes ne vend ne perputhje me Vendimet e Paragrafit 3.5 dhe 3.6 te Udhezimeve.

4 Prokurimi i Punimeve te Vogla

Punimet me kosto te vleresuar = ose me pak se \$ 50.000 per kontrate, deri ne nje shume qe nuk i kalon \$28.000, mund te prokurohen ne kontratat lump-sum, me cmime - fikse te lidhura ne baze te ofertave te marra nga tre (3) kontraktore vendas te kualifikuar ne

pergjigje te nje ftese me shkrim. Ftesa do te perfshije nje pershkrim te hollesishem te punimeve, duke perfshire specifikimet baze, daten.e perfundimit, nje forme te marreveshjes

te pranueshme nga Shoqata, vizatimet perkatese, qe mund te aplikohen. Kontrata lidhet me kontraktorin qe ofron cmimin me te ulet per punen e kerkuar dhe qe ka eksperience dhe burime per te perfunduar kontraten me sukses

Pjesa D: Rishikim nga Shoqata i Vendimeve te Prokurimit

1. Plani i Prokurimit

Para pergatitjes se ftesave per prekualifikim per konkurim ose per konkurim per kontrata, plani i propozuar i prokurimit per Projektin do ti dergohet Shoqates per rishikim dhe miratim, ne perputhje me vendimet e paragrafit 1 te Shtojces 1 te Udhezimeve. Prokurimi i te gjitha mallrave dhe punimeve do te ndermerret ne perputhje me kete plan prokurimi qe do te miratohet nga Shoqata dhe me vendimet e paragrafit 1 te mesiperm.

2. Rishikimi Fillestar

- a) Per cdo kontrate te pjeses B dhe ne lidhje me kontraten e pare sipas paragrafit 1 te Pjeses C, do aplikohen procedurat e percaktuara ne paragrafin 2 dhe 3 te shtojces 1 te Udhezimeve.
- b) Ne lidhje me cdo kontrate te paragrafit 2, 3 dhe 4 te Pjeses C do zbatohen procedurat e meposhteme:

- (i) Selektimi i meparshem te furnitoreve sipas procedurave te blerjes. Huamarresi do ti paraqese Shoqates nje raport mbi krahasimin dhe vleresimin e kuotimeve te marra;
- (ii) para ekzekutimit te cdo kontrate te prokuruar sipas procedurave te kontratave te drejtperdrejta. Huamarresi do ti siguroje Shoqates nje kopje te specifikimeve dhe draftkontraten; dhe
- (iii) do te aplikohen procedurat e percaktuara ne paragrafet 2 (f) dhe 2 (g) dhe 3 te Shtojces 1 te Udhezimeve.

3. Rishikimi i Mevonshem

Ne lidhje me cdo kontrate qe nuk perfshihet ne paragrafin 2 te kësaj Pese, do te aplikohen procedurat e percaktuara ne paragrafin 4 te Shtojces 1 te Udhezimeve.

Seksioni II. Punesimi i Konsulenteve

Pjesa A: Te Pergjithshme

1. Sherbimet e Konsulenteve do te prokurohen ne perputhje me: (a) vendimet e Parathenies dhe Seksionit IV te "Udhezime: Seleksionimi dhe Punesimi i Konsulenteve nga

Huamarresit e Bankes Boterore" botuar nga Shoqata ne Janar 1997 dhe rishikuar ne Shtator 1997 dhe Janar 1999, nenshtuar modifikimeve te percaktuara ne paragrafin 2 te Pjeses A (Udhezime per Konsulentet", dhe (b) vendimet e Pjeseve vijuese te Seksioni II.

2. Ne paragrafin 1.10 te Udhezimeve per Konsulentet, referencat "vendet anetare te Bankes" dhe "vend anetar" mendohen te jene perkatesisht referenca te "Vendeve Pjesemarrese" dhe "Vend Pjesemarres".

Pjesa B. Seleksionimi bazuar ne Cilesine dhe Kosto

1. (Sic thuhet ne Pjesen C te ketij Seksioni), sherbimet e konsulenteve do te prokurohen nen kontratat e lidhura ne perputhje me vendimet e Seksionit II te Udhezimeve per Konsulentet, paragrafi 3 i Shtojces 1, Shtojces 2 dhe vendimet e paragrafeve 3.13 deri ne 3.18 qe aplikohen per seleksionimin e konsulenteve te bazuar ne cilesi dhe kosto.

(2) Vendimet e meposhtme do te aplikojne prokurimin e sherbimit te konsulenteve sipas kontratave te akorduara ne perputhje me vendimet e paragrafeve te meparshem. Short lista e konsulenteve per sherbimin, me nje kosto me te ulet se \$200.000, ose e barabarte, mund te perbeje te tere konsulentet kombetar ne perputhje me vendimet e paragrafit 2.7-te udhezimeve te Konsulentit.

Pjesa C: Procedura te Tjera per Seleksionimin e Konsulenteve

1. Seleksionimi me koston me te ulet

Sherbimet per projektin e auditimit mund te prokurohen per kontrata ne perputhje me vendimet e paragrafit 3.1 dhe 3.6 te Udhezimeve te Konsulentit.

2. Seleksionimi i Bazuar ne Kualifikimet e Konsulenteve

Sherbimet = ose me pak se \$100.000 do te prokurohen per kontrata e lidhura ne perputhje me vendimet e paragrafit 3.1 dhe 3.7 te udhezimeve te Konsulences.


2. Konsulentet Individuale

Sherbimet detyrat e kerkuara te vendosura ne paragrafin 5.1 te Udhezimeve te Konsulenteve do te prokurohen per kontratat e lidhura per konsulentet individuale ne perputhje me vendimet e paragrafeve 5.1 dhe 5.3 te Udhezimeve te Konsulenteve.

Pjesa D: Rishikimi nga Shoqata i Seleksionimit te Konsulenteve

1. Plani i Seleksionimit

Para se t'i dergohen konsulenteve kerkesat per propozime, ~~plani i propozuar~~ per seleksionimin e konsulenteve per Projektin, do t'i dergohet Shoqates per rishikim dhe miratim ne perputhje me vendimet e paragrafit 1 te Shtojces 1 te Udhezimeve per Konsulentet.



Seleksionimi i te gjithë shërbimeve të konsulentëve do të ndermerret në përputhje me këtë plan seleksionimi siç është miratuar nga Shoqata dhe me vendimet e paragrafit 1.

2. Rishikimi Fillestar


(a) Në lidhje me çdo kontratë për punësimin e firmave konsulente për \$100.000 me kosto të barazvlefshme me 100.000 \$ ose më tepër, do të aplikohen procedurat e përcaktuara në paragrafet 1, 2 (përveç nënparagrafit të tretë të paragrafit 2 (a)) dhe 5 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve për Konsulentët.

(b) Në lidhje me çdo kontratë për punësimin e firmave konsulente për 50 000\$ ose më shumë, me kosto më pak ose = 100.000 \$, do të aplikohen procedurat e përcaktuara në paragrafet 1, 2 (përveç nënparagrafit të dytë të paragrafit 2 (a)) dhe 5 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve për Konsulentët.

(c) Në lidhje me çdo kontratë për punësimin e konsulentëve individualë me kosto të = ose më tepër se 25.000 \$ ose më tepër, kualifikimet, eksperiencat, termat e referencës dhe termat e punësimit të konsulentëve do t'i dërgohen me pare Shoqatës për Rishikim dhe miratim. Kontrata do të lidhet vetëm pasi të jete dhënë miratimi.

3. Rishikimi i Mevonshëm

Ne lidhje me cdo kontrate qe nuk ben pjese ne paragrafin 2 te kesaj Pjese do te aplikohen procedurat e percaktuara ne paragrafin 4 te Shtojces 1 te Udhhezimeve per Konsulentet.



KAPITULLI 4

Programi i Zbatimit

1. Huamarresi do të:

(a) mbaje politikat dhe procedurat e pershtatshme të afta për të monitoruar dhe vlerësuar në vazhdimësi, në përputhje me treguesit të kënqshëm për Shoqatën, për të cuar përpara Projektin dhe për të arritur objektivat:

(b) përgatise, nën termat e references të pranueshme për Shoqatën, dhe t'ia paraqese ato shoqatës, në ose rreth 30 qershorit, 2004, një raport ku përfshihen rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit të aktiviteteve të kryera sipas paragrafit (a) të këtij Seksioni, në progresin e arritur për të cuar përpara Projektin gjatë periudhës së mëparshme të dates së raportit dhe në masat që rekomandohen të merren për të siguruar kryerjen me sukses të projektit dhe në arritjen e objektivave gjatë periudhës mbas kësaj date; dhe

(c) rishikimi me Shoqatën, nga 30 Shtator 2004 ose në një datë të mëvonshme kur Shoqata do të kerkojë, raporti referohet paragrafit (b) të këtij Seksioni, dhe, përcaktimin e masave për të siguruar kompletimin efikas të Projektit dhe arritjen e objektivave, bazuar në konkluzionet dhe rekomandimet e thena në raport dhe pikpamjet e Shoqatës për këtë çështje.

2. Huamarresi do të mbaje, të gjitha masat e nevojshme për hartimin e Planit të Menaxhimit të Ambientit në kohën e duhur.

3. Huamarresi do te mbaje, deri ne perfundimin e Projektit, PMU, CGC dhe PSC me burimet, stafin dhe funksionet e pranueshme per Shoqaten.
4. Huamarresi do te pergatise dhe do te paraqese Shoqates nje program pune vjetor dhe buxhetin per Projektin ne 30 Nentor te cdo viti.
5. Huamarresi do te paraqese para Parlamentit, ne 31 Dhjetor, 2001, draftin e Ligjit te Mbrojtjes se Varitetit te Bimeve te pranueshem per Shoqaten., dhe
6. CGC do jete pergjegjese per vleresimin e propozimeve sipas pjeses D2 te Projektit dhe do t'ia paraqesi PMU per miratim.
7. CGC do te :
 - (a) Siguroje qe te gjitha propozimet per nenprojektet do te vleresohen ne perputhje me proçeduren dhe kriteret e percaktuara ne Manualin e Veprimit ne kapitullin 5 te kesaj Marreveshje, dhe
 - (c) PMU duhet te paraqese Shoqates per rishikim dhe konkurim te njezet propozimet e para te nenprojekteve te rekomanduara per aprovim.



8. PMU do të marrë masat e nevojshme për kontrollin e zbatimit të pjesës D.2 të Projektit në përputhje me Manualin e Veprimit.



KAPITULLI 5

Termat dhe kushtet per

Pjesen D. 2 te Projektit

- 1.- Grantet per nenprojektet e Pjeses D.2 do te perdoren per :
 - a) Grupet aktuale te bazuara ne komunitet si fermeret, shoqatat e prodhuesve dhe agroperpunuesve;
 - b) Grupet e fermereve qe bashkepunojne me shoqatat e perdorimit te ujit dhe shoqatat e kursim kreditit;
 - c) Grupet e fermereve te formuar per qellimet e ekstensionit;
 - d) Shoqatat dhe organizatat per te cilat Huamarresit dhe Shoqatat kane rene dakord.
2. Shuma e grandeve individuale do te bazohet ne koston e mallrave punimeve, sherbimeve dhe koston operative per nenprojektet dhe nuk duhet te kaloje 75 % te koston totale dhe kufijte e kategorive individuale te vendosura ne Manualin e Veprimeve.

3. Shpenzimet e pranueshme qe i referohen paragrafit 2 te mesiperm nuk do te financohen nga kredia deri sa Mareveshja e Grantit do te zbatohet nga Marresit e Grantit, CGC dhe PMU.

4 Cdo Mareveshje

5 e Grantit do ti kerkoje marresit te Grantit nder te tjera:

(a) Te siguroje qe fondet e grantit te perdoren ekskluzivisht per qellimet e specifikuar per nenprojektet e aprovuara nga CGC;

(b) Jo me pak se 25 % te kostos totale te nenprojekteve, si ne para ose ne natyre;

(c) Mbajtja e sistemit te Manaxhimit Financiar duke perfshire regjistrimet dhe ndarjen e llogarive ne nje forme te pranueshme nga PMU, duke reflektuar veprimet, burimet dhe shpenzimet e lidhura me nenprojektet;


(d) Prokurimi i mallrave, punimeve dhe sherbimeve te financuara nga Granti ne perputhje me Udhhezimet dhe Udhhezimet e Konsulentit te percaktuara ne paragrafin 3 dhe 4 te Pjeses C te Seksionit 1 dhe Paragrafit 2 te Pjeses C te Seksionit II te Kapitullit 3 te kesaj Marreveshje;

- (e) Te lejoje stafin e PMU ose CGC te inspektoje zonat, punimet dhe mallrat te financuara nga Granti; dhe
- (f) Marreveshja ku granti mund te pezullohet ose mbyllet kur aktiviteti i marresit te Grantit deshton per te plotesuar detyrimet e vendosura ne Marreveshjen e Grantit dhe eshte ligjerisht i detyruar me mbarimin e Marreveshjes, te rimbursoje PMU per grantet e marra.

Vertetim i perkthimit zyrtar te marreveshjes

Konfirmojme se perkthimi ne shqip bashkengjitur i Marreveshjes se Kredise per Projektin e Sherbimeve Bujqesore ndermjet Shqiperise dhe Shoqates per Zhvillim Nderkombetar eshte korrekt dhe perputhet me origjinalin.




Ilir Zeko

Drejtor i Thesarit dhe Borxhit
Ministria e Financave